



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1751/3 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.243, datë 28.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 87, DATË 18.04.2017,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË MALLAKASTËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 87, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017”, në Bashkinë Mallakastër,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.81, datë 19.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Mallakastër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit në Bashkinë Mallakastër, prej datës 27.04.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 87, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Mallakastër të anulojë pikat 1 dhe 2, të aktit administrativ nr. 204, datë 18.08.2016, që emëron në detyrë respektivisht punonjësit:

- ✓ ***** (pika 1, e aktit), në pozicionin “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve”, pranë Bashkisë Mallakastër;

✓ ***** (pika 2, e aktit), në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arkivi dhe IT”, pranë Bashkisë Mallakastër.

2. Njësia përgjegjëse të hartojë planin e punës së pranimeve në shërbim civil për vitin 2017, duke përfshirë pozicionet e punës më sipër dhe pozicionet e punës të plotësuar në kundërshtim me ligjin, të cilat janë evidentuar dhe trajtuar më parë nga Komisioneri në vendimin nr. 81, datë 19.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 334 prot., datë 18.04.2016” dhe që njësia përgjegjëse nuk i ka plotësuar ende me anën e procedurave të konkurrimit.

3. Pozicionet në fjalë duhen shpallur si të lira dhe të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

4. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30** ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 87, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017”, me Vendimin Nr. 221, datë 31.10.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 87, datë 18.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017’”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 87, datë 18.04.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Migena Haznedari, Joni Marko dhe Stela Ndoka, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me

Jashtë, të cilët në datën 10.11.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Mallakastër.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Mallakastër dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1751/2 prot., datë 31.10.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 10.11.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Mallakastër.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë, e më tej, njësisë përgjegjëse të institucionit, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me emërimin në kundërshtim me ligjin të 2 punonjësve (***** dhe *****) të anulojë aktet e emërimit, duke e kryer këtë proces në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së lirë të pozicioneve të mbajtura prej tyre dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, në përputhje me nenet 22, 23 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi në subjekt dhe komunikimi me njësinë përgjegjëse të institucionit (njësinë e burimeve njerëzore), rezultoi sa më poshtë:

Në strukturën aktuale të Bashkisë Mallakastër, miratuar me Vendimin Nr. 58, datë 28.12.2016, rezulton se pozicioni “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve”, nuk ekziston më.

Me Urdhrin e Brendshëm Nr. 113, datë 10.05.2017, “Në zbatim të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për revokimin e kontratës së punës”, Kryetari i Bashkisë në pikën I të këtij akti ka urdhëruar revokimin e kontratës së punës për punonjësin *****, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”. Kryetari i Bashkisë Mallakastër ka gabuar kur ka përdorur termin revokim në këtë rast, në një kohë kur në vendimin e Komisionerit është kërkuar anulimi i aktit të emërimit.

Në vështrim të neneve 110 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, akti absolutisht i pavlefshëm duhet të konstatohet si i tillë dhe të anulohet nga organi publik që e ka nxjerrë atë. Termi

“revokim” nuk përmendet në asnjë rast gjatë përmbajtjes së këtij ligji. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mallakastër dhe njësisë përgjegjëse të këtij institucioni duhet të tregohet kujdes që kjo pasaktësi të mos përsëritet më në të ardhmen.

Në pikën II të këtij urdhri, parashikohet sa vijon: “Ky urdhër hyn në fuqi, në datën e shpalljes së fituesit, pas realizimit të konkurrimit të pozicionit të shërbimit civil.”. Nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore, grupi i punës u informua se Kryetari i Bashkisë Mallakastër i ka dhënë këtij akti efekt të vonuar për të mos penguar mbarëvajtjen e punës. Në momentin e verifikimit në subjekt, grupi i punës konstatoi një numër shumë të lartë vendesh vakante, për të cilat duhet të kryheshin procedurat e konkurrimit në përputhje me ligjin. Pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, është një pozicion i rëndësishëm, për shkak të rolit që ka në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për administrimin e shërbimit civil.

Në zbatim të **pikës 2 të vendimit** paralajmërues, njësia përgjegjëse e Bashkisë Mallakastër me Vendimin Nr. 44, datë 28.02.2017 “Miratimin e Planit Vjetor të pranimeve në shërbimin civil, për vitin 2017”, ka hartuar planin e punës së pranimeve në shërbimin civil në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimet në shërbimin civil”, duke përfshirë në të edhe pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”.

Në **pikat 3 dhe 4 të vendimit**, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse që pozicionet “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve” dhe “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, të shpallen të lira dhe të plotësohen në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore përkatëse.

Sikundër u parashtrua edhe gjatë trajtimit të pikës 1 të vendimit objekt verifikimi, pozicioni “Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Pyjeve” nuk ekziston më në strukturën aktuale të Bashkisë Mallakastër.

Me shkresën nr. 2090 prot., datë 20.11.2017, “Ridërgim për shpalljen e pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore””, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njësia përgjegjëse ka dërguar shpalljen e pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”. Në përfundim të këtij procesi, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin, duke bashkëngjitur edhe aktet përkatëse që materializojnë zbatimin e kësaj pike.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 87, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar plotësisht rekomandimet e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 87, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 22, datë 10.02.2017”, në Bashkinë Mallakastër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Mallakastër, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 87, datë 18.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Mallakastër dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha